



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:026593

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05751409

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja Ilirjana Hoti, me sekretaren juridike Flutur Nagavci , në çështjen penale kundër të akuzuarve E. B. nga Hajvalia K- Prishtin , A. H. nga fshati . . . K. Vushtri , L. R dhe L. S. që të dyja nga Peja , për shkak të veprës penale vjedhje e rënd në bashkëkryerje nga neni 315 par.1 nën. par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së , sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.575/2018 të datës 31.07.2018 të pranuar në gjykatë me datë 09.08.2018, në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datë 24.05.2024 , në prani të Prokurorit të shtetit Qazim Kuqi , mbrojtësit të akuzuarin E. B. av. Fehmije Gashi – Bytyqi, sipas autorizimit , mbrojtësit të akuzuarit A. H. a av. Avdi Rizvanolli sipas detyrës zyrtare , mbrojtësit të akuzuarës L. R. av Agim Mmuhaxhiri sipas autorizimit , mbrojtësit të akuzuarës L. S. av. Asdren Bytyqi sipas autorizimit dhe të akuzuarve , me datë **29.05.2024** , mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **E. B.**, nga i ati SH., e ëma M, e lindur G, data e lindjes . . . në Prishtinë, me banim në . . .” p.nr., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët i martuar , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal. . . .

I akuzuari **A. H.**, nga i ati S., e ëma H, e lindur K, data e lindje . . . në Prishtinë, me vendbanim në fshatin . . . , Komuna Vushtri, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë , i gjendjes së dobët ekonomike, beqar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal. . . .

E akuzuara **L. R.**, nga i ati Sh, e ëma N, e gjinisë H, data e lindjes . . . në Pejë, ku edhe tani jeton, Rr." . . , ka të kryer shkollën së dobët ekonomike n e mesme ,dizajnere , e gjendjes së dobët ekonomike, e pa martuar , shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, me numër personal. . .

E akuzuara **L. S.**, nga i ati G, e ëma B, e gjinisë F., data e lindjes . . . në Bari — Mali i Zi, me vendbanim në Pejë, Rr." . . . , ka të kryer shkollën e mesme, punëtoare, e gjendjes së dobët ekonomike , e pa martuar ishqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, me numër personal, . . .

J a n ë F a j t o r

Sepse:

- Me datë 06.04.2018, rreth orës 04:20, në rrugën "Nënë Terezë" në Gjakovë, me qëllim të përfitimi të kundrlishëm pasuror për vete ia marrin pasurinë të dëmtuarit D. ZH., në atë mënyrë që pasi marrin një veturë me qira në renta-car ". . ." në Prishtinë, të tipit ". . ." me targa të regjistrimit . . . , merren vesh në mes vete që të vijnë në Gjakovë me qëllim të vjedhjes ashtu që pasi i ndajnë rolet e parkojnë veturën dhe derisa i pandehuri A. H.ka qëndruar duke bërë roje në veturë, ndërsa e pandehura L. ka dalë nga vetura dhe kanë bërë roje me qëllim të verifikimit të terrenit rreth lokalit, derisa i pandehuri E. B. me një sopat me bisht të shkurtër thyen derën e argjendarisë ". . ." pronë e të dëmtuarit, ashtu që futet brenda në lokal së bashku me të pandehurën L. dhe nga aty marrin: 18 orë dore të markave të ndryshme në vlerë prej 885 euro, 48 palë vathë (bizhuteri) në vlerë prej 550 euro, 32 zingjir për qafë (argjend dhe bizhuteri) në vlerë prej 2750 euro dhe tri unaza në vlerë prej 150 euro, pastaj me sendet e vjedhura futen në veturë dhe derisa kanë qenë duke lëvizur në qytet, gjatë një kontrolli rutinë nga policia, ndalohen dhe pasi që i pandehuri E. në cilësinë e vozitësit nuk kishte patentë shofer, dërgohen në Stacionin Policor në Gjakovë dhe gjatë kontrollimit në veturë, gjenden sendet e vjedhur në vlerën e përgjithshme prej 4335 euro, të cilat pastaj sekuestrohen dhe më vonë pas verifikimit i kthehen të dëmtuarit.

_ me çka kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 327 par.1 nën. par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në kuptim të dispozitës së nenit 2,3, 4, 6, 7, 17, 38, 39 par. 1. nën par. 1.2, neneve 43, 46 par. 1 nën par. 1.1 dhe par. 2 nën par. 2.2, nenit 47, 48, 49, 50, , 69, 70, 71 par. 1 nën par.1.1dhe . 1.3 , 72 par 1 nën. par.1.3, nenit 315 par.1 nën. par.1.1lidhur me nenin 31 të KPRK-së , nenit 365, 450 dhe 463 të KPP të Republikës së Kosovës, të akuzuarit i :

G J Y K O N

I .Të akuzuarin **E. B.** ;

Dënimin me gjobë në shumë prej **100 (njëqind) euro**, të cilin dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, si dhe

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **18 (tetëmbëdhjetë) muaj** , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **2 (dy) viteve** , nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, e në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet .

Nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj gjobën, gjykata konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, mund ta zëvendësoi dënimin me gjobë në shumë prej **100 (njëqind) euro**, në dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 5 (pesë) ditësh duke ia llogaritur 20 (njëzet) euro për një ditë burgimi.

II. Të akuzuarin **A. H.;**

Dënimin me gjobë në shumë prej **100 (një qind) euro**, të cilin dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, si dhe

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **13 (trembëdhjetë) muaj** , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **2 (dy) viteve** , nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, e në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet .

Nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj gjobën, gjykata konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, mund ta zëvendësoi dënimin me gjobë në shumë prej **100 (njëqind) euro**, në dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 5 (pesë) ditësh duke ia llogaritur 20 (njëzet) euro për një ditë burgimi.

III. Të akuzuarën L. R.;

Dënimin me gjobë në shumë prej **100 (një qind) euro**, të cilin dënim është e detyruar që ta paguaj në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, si dhe

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **18 (tetëmbëdhjetë) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara brenda kohës së verifikimit në afatin prej **2 (dy) viteve**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, e në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet .

Nëse e akuzuara nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj gjobën, gjykata konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, mund ta zëvendësoi dënimin me gjobë në shumë prej **100 (njëqind) euro**, në dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) ditësh duke ia llogaritur 20 (njëzet) euro për një ditë burgimi.

IV. Të akuzuarën L. S. ;

Dënimin me gjobë në shumë prej **100 (dyqind) euro**, të cilin dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, si dhe

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **18 (tetëmbëdhjetë) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara brenda kohës së verifikimit në afatin prej **2 (dy) viteve**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, e në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet .

Nëse e akuzuara nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj gjobën, gjykata konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, mund ta zëvendësoi dënimin me gjobë në shumë prej **100 (dyqind) euro**, në dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditësh duke ia llogaritur 20 (njëzet) euro për një ditë burgimi

I akuzuari D. ZH. nga Gjakova ,për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohen të akuzuarit që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajnë shpenzimet në shumë prej nga 20.00 €, si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej nga 30.00 €, në afat prej 15 ditëve , pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Konform nenit 270 të KPPRK-së, konfiskohet sopata , si mjet me të cilin është kryer vepra penale, i sekuestruar me datë 06.04.2018.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me PP/II.nr.575/2018 të datës 31.07.2018 të pranuar në gjykatë me datë 09.08.2018,, të pranuar në gjykatë me datën 14.11.2022 , ka akuzuar të akuzuarit akuzuarve E. B. nga . . . K-Prishtinë , A. H.nga fshati . . . K.Vushtri , L. R. dhe L. S. që të dyja nga Peja , për shkak të veprës penale vjedhje e rënd në bashkëkryerje nga neni 315 par.1 nën. par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së .

Gjykata konstaton se me aktvendimin P.nr. 540/18 të datës 09.09.2029 , ka pezulluar mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor me qenë se i akuzuari E. B. nuk ka marr pjesë në shqyrtimin fillestar të caktuar 09.09.2019 për të cilin është lëshuar urdhëresë për shoqërim me detyrim nga st. Policor në Prishtinë , mirëpo përmes e-mailit me datë 09.09.2019 , gjykata nga zyrtari policor S. R.– Reshter , jemi njoftuar se

i akuzuari është kërkuar disa herë në shtëpi por është duke qëndruar në arrati , i njëjti është i dënuar edhe nga gjykatat tjera dhe për këtë është duke iu shmangur ftesave të gjykatës dhe policisë dhe nuk kanë ndonjë informacion se i njëjti gjendet jashtë Kosovës , andaj për të njëjtin ka lëshuar edhe urdhër arrest P.nr. 540/18

Pasi gjykata është njoftuar nga mbrojtësja e të akuzuarit se i akuzuari ndodhet në vuajtje të dënimit në Burgun e Dubravës si dhe me kërkesën e saj gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar duke i ftuar të gjitha palët në procedurë .

Prokurori e shtetit Qazim Kuqi , gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 24.05.20243 pas leximit të aktakuzës aktakuzën PP/II.nr.575/2018 të datës 31.07.2018 deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I pandehuri E.B.,gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë deklaroi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë dhe i njëjti lidhur me fajësinë pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësen e tij av. Fehmiye Gashi Bytyqi deklaroi: ndihem fajtor për veprën penale me të cilën pandehem e të cilin pranim e fajësisë e kam bërë ne çdo fazë të procedurës , kërkojë falje nga i dëmtuari për veprimet e mia , premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet , andaj gjykatës i propozoi të me shqiptojë një dënim me të butë duke marr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese

Mbrojtësja av. Fehmiye Gashi Bytyqi deklaroi se e përkrahi ne tërësi pranimin e fajësisë nga këtu i mbrojturi im , pasi që ky pranim i fajësisë është bere pas konsultimit të mjaftueshëm me të , me që edhe kam qenë ne burgun e Dubravës dhe kemi biseduar për këtë çështje, andaj lus gjykatën e të ketë vëmendje të veçantë se pranimi i fajësisë për veprimet antiligjore është bere qyshe në kontaktin e parë me policinë ,andaj propozoi gjykatës që të aprovohet pranimi i fajësisë. Lidhur me vendimin për dënimin mbrojtësja e të akuzuarit deklaroi se lus gjykatën që gjatë matjes se llojit dhe lartësisë se dënimit , E. B.t, ti jep një dënim të kushtëzuar ,kjo nga rrethanat: se i njëjti që në kontaktin e parë me policinë e ka pranuar veprën penale ,ka qenë i një moshe të re pa i mbushur 19 vjet, gjendja e dobët ekonomike, si dhe faktin se tani me është me i pjekur ,sapo është martuar ku bashkëshorten e ka ne Gjermani ,faktin se për fatin e mirë falë policisë se Gjakovës, sendet e vjedhura ne tërësi i janë kthyer palës se dëmtuar , andaj të gjitha këto rrethana lehtësuese do të përbënin një arsytim ligjor që të mbrojturit tim ti shqiptohet një dënim me kusht i cili natyrisht do të ishte një kërcënim serioz ,se nëse i njëjti eventualisht benë veprime anti ligjore të tjera do të kthen ne dënim me burgim .

I pandehuri i E.B., deklaroi se mbështet në tërësi deklarimin e dhënë nga mbrojtësit të tij dhe shtojë se për veprën që e kam kryer jam penduar dhe ndihem i turpëruar dhe ju kisha lutur që të me shqiptohet një dënim me të butë ose një dënim me kusht me qenë se jam ne vuajtje të dënimit me burg, i cili dënim ka ndikuar tek unë që të ri socializohem në të ardhmen dhe mos të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme .

I pandehuri A. H., deklaroi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë dhe i njëjti lidhur me fajësinë pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av. Avdi Rizvanolli deklaroi: ndihem fajtor për veprën penale me të cilën pandehem, kërkojë falje nga i dëmtuari për veprimet tona, premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, andaj gjykatës i propozoi të me shqiptojë një dënim me të butë duke marr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese e posaçërisht faktin me parë e as pas këtij rasti nuk kam ra ndesh me ligjin .

Mbrojtësi av. Avdi Rizvanolli ,deklaroi se e përkrahi ne tërësi pranimin e fajësisë nga këtu i mbrojturi im , pasi që ky pranim i fajësisë është bere pas konsultimit të mjaftueshëm me të , duke i ditur edhe me parë pasojat dhe favoret e pranimi të fajësisë , andaj lus gjykatën që të aprovojë pranimin e fajësisë . Lidhur me vendimin për dënimin deklaroi se lus gjykatën që gjatë matjes se llojit dhe lartësisë se dënimit , të ketë parasysh se i mbrojturi im A. për herë të parë ballafaqohet me dispozitat ligjore dhe se

gjere me tani asnjëherë nuk ka ra ndesh me ligjin. I propozoi gjykatës që të e te njëjtit ti caktohet ndonjë dënim me kusht ku afati i dënimit te jetë sa me i shkurtër.

I pandehuri A. H., deklaroi se mbështet në tërësi deklarin e dhënë nga mbrojtësit te tij.

E pandehura L. R. , deklaroi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe e njëjta lidhur me fajësinë pas konsultimit te mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av. Agim Muhaxhirin deklaroi: ndihem fajtor për veprën penale me te cilën pandehem, kërkojë falje nga i dëmtuari për veprimet tona, premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet, andaj gjykatës i propozoi te me shqiptojë një dënim me te butë duke marr parasysh te gjitha rrethanat lehtësuese

Mbrojtësi av. Agim Muhaxhiri ,deklaroi se e përkrahi ne tërësi pranimin e fajësisë nga këtu i mbrojturi im , pasi qe ky pranim i fajësisë është bere pas konsultimit te mjaftueshëm me te, duke i ditur edhe me parë pasojat dhe favoret e pranimit te fajësisë , andaj lus gjykatën qe te aprovojë pranimin e fajësisë . Lidhur me vendimin për dënimin deklaroi se e mbrojtura ime paraprakisht e ka pranuar fajësinë në çdo fazë te procedurës, është penduar për veprimet e saja te kundërligjshme , premtun se nuk do te përsërisë vepra te njëjta apo te ngjashme penale , dhe e njëjta nga dita e kryerjes se veprës penale 06.04.2018 e gjere me ditën e sotme kanë kaluar 6 vite , nuk ka kryer vepër te re penale. E njëjta ka qenë ne vuajtje te dënimit për vepra tjera te mëhershme dhe dënimin e ka kryer , gjatë kohës sa ka qëndruar ne ekzekutim te vuajtje se dënimit për shkak te sjelljeve te saja ,ka marr pëlqimin nga institucioni i ekzekutimit te vuajtjes se dënimit ,ka fituar falje te dënimit dhe zbutje te dënimit, te cilat mund te ja prezantojmë gjykatës. Për këtë arsye gjatë kohës se kryerjes se ekzekutimit te dënimit e njëjta është rehabilituar dhe i është zbutur dhe falur dënimi , duke marr parasysh te gjitha këto rrethana trajtojmë se është rehabilituar mjaftueshëm dhe çfarëdo dënimi me burg efektiv nuk do te ketë efekt ne rehabilitimin e saj, me qe rehabilitimin, falja dhe zbutjen e dënimit e ka fituar pas kryerjes se veprës penale .Duke marr për bazë sjelljen e saj gjatë gjykimit përgjigjes ne ftesë ,pranimit te fajësisë si dhe tjerë te cekuar me lartë , e njëjta tani është e fejuar dhe në muajin korrik pritet te martohet ,duke marr për bazë se demi i shkaktuar te dëmtuarit gjësendet e vjedhura i janë kthyer te njëjtën ditë, kërkojë nga gjykata me qe askush nuk është i dëmtuar, kërkojë nga gjykata ti shqiptohet një dënim i kushtëzuar .

E akuzuara L. R. deklaroi se mbështet në tërësi deklarin e dhënë nga mbrojtësit te tij.

E pandehura L. S. , deklaroi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe i njëjti lidhur me fajësinë pas konsultimit te mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av. Asdren Bytyqi deklaroi: ndihem fajtor për veprën penale me te cilën pandehem, kërkojë falje nga i dëmtuari për veprimet tona, premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet, andaj gjykatës i propozoi te me shqiptojë një dënim me te butë duke marr parasysh te gjitha rrethanat lehtësuese .

Mbrojtësi av. Asdren Bytyqi ,deklaroi se e përkrahi ne tërësi pranimin e fajësisë nga këtu i mbrojturi im , pasi qe ky pranim i fajësisë është bere pas konsultimit te mjaftueshëm me te, duke i ditur edhe me parë pasojat dhe favoret e pranimit te fajësisë , andaj lus gjykatën qe te aprovojë pranimin e fajësisë. Lidhur me vendimin për dënimin deklaroi se i propozoi gjykatës qe si rrethanë lehtësuese te merr faktin se e mbrojtura ime ka pranuar fajësinë qe nga momenti i parë nga ndalimi policor, ka qenë bashkëpunuese , ka qenë ne moshë shumë te re, 18 vjeç, qe nga ajo kohë nuk ka përsëritur asnjëherë dhe asnjë lloje vepër penale, është e fejuar, pritet te martohet këtë verë dhe po ashtu qëndrojnë edhe deklarinet e av. Agim Muhaxhiri , pasi qe edhe e mbrojtura ime ka përfunduar dënimin për vepra te me parme , është përfshirë ne falje te dënimit nga ish presidenti i shtetit dhe ka fituar lirinë me kusht , gjë qe tregon e ka përfunduar me sukses procesin e rehabilitimit dhe risocializimit te konstatuar nga organet kompetente. I propozoi gjykatës qe te njëjtës ti shqiptojë një dënim te kushtëzuar .

E akuzuara L. S. deklaroi se mbështet në tërësi deklarinimin e dhënë nga mbrojtësit e tij.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari Prokurori i shtetit Qazim Kuqi , deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë të bere nga ana e te akuzuarve në kete seancë te shqyrtimit fillestar, pasi qe pranimi i fajësisë është bere pas konsultimit te mjaftueshëm me mbrojtësit e tyre ,pranimi i fajësisë është bere vullnetarisht ,pa presion , duke i ditur pasojat dhe benefitet e një pranimi te tillë ,pranimi i fajësisë ka mbështetjeje në provat materiale dhe personale qe i janë bashkangjitur aktakuzës dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje dhe gabim faktik ,andaj gjykatës i propozoi qe te aprovohet pranimi i fajësisë, pasi qe janë përmbushur te gjitha kërkesat ligjore nga neni 242 te KPRK-ës. Lidhur me vendimin për dënimin deklaroi se me rastin e caktimi te llojit dhe lartësisë se dënimit gjykatës i propozoi qe si rrethanë renduese te merret parasysh shkallen e përgjegjësie penale te akuzuarve si dhe rrezikshmërinë konkret te veprës penale , ndërsa si rrethana lehtësuese te merr parasysh pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarve , si dhe faktin se ka kaluar një kohë e gjatë nga kryerja e kësaj vepre penale.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata pas dëgjimit të palëve, ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë së bërë nga ana e të akuzuarve, është bërë në pajtim me nenin 242 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjykata konstatoi se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarve pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësit e tyre , pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuar nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjykata ka vërtetuar këto gjendje faktike: sete akuzuarit E. B., A. H., L. R. dhe L. S. , me dashje kanë kryer veprën penale vjedhje e rënd në bashkëkryerje nga neni 315 par.1 nën.par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në diapozitivin e këtij Aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Sipas nenit 315 par.1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale Vjedhje e rënd e kryen: “*Kushdo që kryen vjedhje nga paragrafi 1. i nenit 313 të këtij Kodi, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjet, nëse:*

1.1. vepra është kryer duke thyer, kaluar apo depërtuar me forcë në veturat e mbyllura, ndërtesat, dhomat, arkat, sanduqet apo hapësirat tjera të mbyllura ose duke hequr pengesat tjera me qëllim të përvetësimit të pasurisë së luajtshme;

5. Vendimet e gjykatës

Andaj, duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, gjykata të akuzuarit , i ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohen sipas aktakuzës së lartcekur, ngase në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprës penale Vjedhje e rënd në bashkëkryerje nga neni 315 par.1 nën. par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, prandaj për këtë ka vendosur që të akuzuarit ti gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoj të gjitha rrethanat konform nenit 69,70 dhe 71 paragraf 1 nën paragraf 1.3 të KPRK-së, që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Si rrethanë rënduese për të akuzuarin konstaton faktin se të akuzuarit kanë kryer veprën penale të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi si dhe faktin se i akuzuari E. B. edhe më parë ka qenë i dënuar për vepra penale ku sipas Evidencës penale të personave të dënuar, i lartë përmenduri evidentohet me lëndën penale PKR.nr.165/18 -neni 327, 329 ,347 - Dënim me burg 3vite e 10 muaj dhe gjobë 1500 euro Pf.11.10.2019 Gj. Prishtinë dhe është në vuajtje të këtij dënimi , e akuzuara L. R. e njëjta evidentohet me lëndët penale : PKR.nr.165/18 –neni 329 , Dënim me burg 3vite e 10 muaj dhe gjobë 500 euro Pf.11.10.2019Gj Në Prishtinë ; P.nr.25662/18 –neni 331/1 dënim me gjobë 200 euro –Pf.29.11.2010- Gj. Prishtinë dhe P.nr.1162/ 18 –neni 372/2 –Dënim me burg 1 vit dhe gjobë 300 euro –Pf.07072020 Gj . Prizren ndërsa e akuzuara L. S. evidentohet me lëndët penale : PKR.nr.165/18 –neni 329 , Dënim me burg 3vite e 10 muaj dhe gjobë 500 euro Pf.11.10.2019Gj Në Prishtinë dhe P.nr.1162/ 18 –neni 372/2 –Dënim me burg 1 vit dhe gjobë 300 euro –Pf.07072020 Gj . Prizren., ,ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarve se të njëjtit kanë qenë të moshës së re në kohën e kryerjes së veprës penale , i akuzuari A. H., rezulton se nuk ka lende me dënime penale në evidencën penale të personave të dënuar, të gjendjes tejte të dobët ekonomike, sjelljen tejte korrekte në gjykim, të vetëdijshëm për pasojat e shkaktuara, janë penduar thellë për veprën penale të kryer. Ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë nga të akuzuarit në çdo fazë të procedurës ,shprehjen e keq ardhjes për veprimet e tyre , premtimi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet , kërkim falja nga i dëmtuari për veprimet e tyre kthimi i gjësendeve të dëmtuarit të njëjtën ditë nga zyrtaret policorë koha e kryerjes së veprës penale pasi pas kësaj vepre penale të njëjtit nuk janë të ngarkuar me vepra tjera penale ,të cilat rrethana ndikuan që për të akuzuarit gjykata në rastin konkret ti aplikoj kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 72 par.1 nën. par.1.3 të KPRK-së , kur iu ka shqiptuar dënimin me burgim nën minimumin ligjor si në dispozitiv të aktgjykimit, ngase gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 dhe 47 të i KPRK-së, me bindje se ky dënim të shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit dhe se dënimi e shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tyre, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimit të ligjit

7. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Gjykata, duke u bazuar në nenin 462 paragrafi 2 të KPP, ka vendosur që të dëmtuarin D. ZH. për realizimin e kërkesës pasurore juridike ta udhëzojë në kontest të rregullt juridiko civil, ngase të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë të kërkesës pasurore juridike,

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Sa i përket vendimit mbi shpenzimet procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor u murr në bazë të nenit 450 par.1dhe 2 nën par. 2.6 të KPPK-së , ndërsa vendimi mbi pagimin e shumës prej 20.00 euro , u murr konform nenit 39 paragraf 3 nën paragraf 3.1 të Ligjit nr. 05/L-036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Duke u bazuar në të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
2018:026593 më datë 29.05.2024**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gjyqtarja
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **30 ditësh**, nga dita e marrjes se tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate